



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**SEKRETARIATI**

---

**Njoftim për Shtyp**  
**(datë 02 Korrik 2007)**

**Mbi kërkesën për autorizimin e njoftimit të përqëndrimit të kompanisë  
Strabag.... me Rasperia Trading Limited**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, në bazë të ligjit nr 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 10,12 dhe nenet në vijim për përqëndrimet, është paraqitur një kërkesë për një kontroll të përbashkët(blerje të aksioneve) të shoqërisë Strabag.

Pala përfituese e kontrollit të përbashkët përbëhet nga ana e shoqërive Rasperia Trading Limited(Rasperia) e cila kontrollon gjithashtu aksionet e Basic Element Company Limited, Raiffeisen-Holding Niederlosterreich(R-H) dhe Uniqa Versicherten Cherungen AG(Uniqa) të cilat synojnë një kontroll të përbashkët të shoqërisë Strabag.

Aktivitetet e biznesit të këtyre sipërmarrjeve janë si vijon:

- për Strabag: ndërtim dhe materiale ndërtimi;
- për Uniqa: sigurimet;
- për R-H, administrimi dhe pjesëmarrje në një sërë degësh të industrisë
- për Rasperia: elementët bazë, energjia/alumin, prodhimi i makinave, minierat, shërbimet financiare, materialet e ndërtimit dhe pasuritë e paluajtshme.

Autoriteti i Konkurrencës është i interesuar të dijë opinionin dhe do të marrë në konsideratë çdo koment për këtë kërkesë. Komentet me shkrim mund të adresohen në adresën:

Autoriteti i Konkurrencës  
Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut  
Rruga “Sami Frashëri”, nr.4, kati IV  
Tiranë, Shqipëri  
[www.caa.gov.al](http://www.caa.gov.al)  
[competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al)